

REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1446/2 prot.

Tiranë, më 02.05.2023

VENDIM

Nr. 30, datë 02.05.2023

PËR

“MIRATIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA E SHKOLLIMIT DHE PËRFITIMIN E BURSËS PËR STUDENTIN SONILA NIKOLLI, ME NOTË MESATARE 9-10, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023, E CILA STUDION NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim Relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 1453/3 prot., datë 02.05.2023 “Mbi miratimin e kërkesës për bursë dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2022-2023, të studentes së Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Sonila Nikolli”, në mbledhjen e datës 02.05.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë përjashtimin nga tarifa e shkollimit dhe përfitimin e bursës për studentin Sonila Nikolli, për vitin akademik 2022-2023, e cila studion në një program studimi të ciklit të parë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Efekti financiar total në vlerën 130,000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë përballohet nga Buxheti i Shtetit si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të UMT-së.

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI



ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ